



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 10.2.2023

Nr: 5

Ora: 13:00

V E N D I M

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 2, DATË 31.10.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR LLOJIN DHE KARAKTERISTIKAT TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJNË SISTEMET DHE PAJISJET E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE QË PROKUROHEN DHE PËRDOREN NË ZGJEDHJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja "e" dhe të nenit 22, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në shkronjën "c", të pikës 5, të vendimit nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"...Përrjashtimisht, për qëllim të pasqyrimit të pjesëmarrjes në zgjedhje, çdo pajisje elektronike e identifikimit të mundësojë transmetimin periodik të të dhënave statistikore mbi pjesëmarrjen gjatë ditës së zgjedhjeve dhe statusin e qendrës së votimit, drejt serverit në cloud të KQZ, dhe jo anasjelltas, në mënyrë të sigurt dhe pa çenuar integritetin e informacionit. Rregullat e hollësishme për llojin e të dhënave që transmetohen nga pajisja PEI dhe mënyrën e transmetimit miratohen me akt të posaçëm të Komisionit Rregullator..."

2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Data: 10.2.2023 Nr: 5  
Ora: 13:00



"Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë"

**Ilirjana NANO**

**Kryetar**

**Arens ÇELA**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar**

Data: 10.2.2023 Nr: 5  
Ora: 13:00



“Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”